



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI BASHKIAK**

**RAPORT PER VENDIMARRJEN DHE PERFORMACEN E KESHILLIT TE
BASHKISE KOLONJË PER VITIN 2025**

Viti 2024 ka qenë një vit pune intensive për Këshillin e Bashkisë Kolonjë. Eshte viti kur kemi bërë të mundur një aktivitet të vazhdueshem si në vendimarrje edhe në komunikim të vazhdueshëm me qytetaret dhe komunitetin e bashkisë sonë.

Duke u bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe në Rregulloret e funksionimit të Këshillit bashkiak, të miratuara që në vitin 2020 me asistencen e Projektit Bashki të Forta, Këshilli, si organ i vetëqeverisjes vendore ka ushtruar rolin e vet vendimarrës, përfaqësues dhe mbikqyrës/monitorues.

VENDIMARRJA:

Gjatë vitit 2025 janë realizuar në total 16 mbledhje të Këshillit, 12 prej tyre të radhës dhe 4 mbledhje jashtë radhe me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë.

Në total janë miratuar 157 vendime prej të cilave 134 janë konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë, ndërsa 13 vendime nuk janë konfirmuar nga institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë.

Pjesëmarrja e këshilltarëve në mbledhjet e Këshillit bashkiak ka qenë në masën 85%. Kjo do të thotë se kemi ende për të bërë, jo vetëm për të arritur kuorumin e mbledhjes, por për të pasur prezent të gjithë ose shumicën dërrmuese të këshilltarëve në cdo mbledhje.

Kryesia e Këshillit Bashkiak ka funksionuar rregullisht duke zhvilluar mbledhjet për diskutimin e pikave të rendit të ditës të propozuara nga ekzekutivi dhe ushtruar vendimarrjen për thirrjen e mbledhjeve të këshillit dhe publikimin e rendit të ditës të saj.

Mbledhjet e Komisioneve tashmë parashikohen dhe publikohen si pjesë e rendit të ditës së mbledhjeve të këshillit. Janë realizuar 12 mbledhje komisionesh. Mbetet sfida angazhimi më i madh i këshilltarëve në mbledhjet e komisioneve, si dhe dokumentimi i veprimtarisë, kontributeve dhe mendimeve që jepen nga anëtarët e komisioneve.

Gjatë 2025 të gjitha mbledhjet janë zhvilluar në sallën e Këshillit Bashkiak. Të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë transmetuar live në faqen e Facebook- të Këshillit Bashkiak, cka ka bërë që komuniteti të ndjekë direkt mbledhjen madje të jape dhe mendimet dhe sugjerimet e tij për vendimet dhe çështjet që janë shqyrtuar. Në vitin 2025 janë regjistruar 1.3K followers, dhe 1.1K like, në faqet e FB, ndërkohë që totali i shikimeve për mbledhjet rezulton të jetë 1.6K shikues në total për gjithë vitin. Transparenca e mbledhjeve të këshillit si dhe publikimi i projekt-vendimeve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI BASHKIAK

dhe proces-verbaleve të mbledhjeve, kanë rritur mundësinë për akses të qytetareve në vendimmarrje.

Gjatë 2025 kemi implementuar Planin e aktiviteteve të Këshillit Bashkiak të shoqëruar me buxhetin përkatës prej 4,117,440 lekë, I cili është realizuar në masën 60%.

Ndërkohë që kemi vijuar punën duke implementuar rregulloret e Këshillit dhe Planin e Aktiviteteve, rezulton se në bashkëpunim me këshilltarët, administratën dhe komunitetin kemi arritur zbatimin e planit të aktiviteteve në masën 90%.

Sfidë për 2025, që do të vijojmë ta kemi edhe në 2026 është funksionimi i plotë i komisioneve, trajnimi i vazhdueshëm dhe dokumentimi e publikimi i veprimtarisë së tyre.

Në këtë proces këshilli është asistuar nga Projekti “Bashki të Forta”, gjë e cila do të vijojë edhe për 2026 si në drejtim të zhvillimit të trajnimeve dhe ofrimit të dokumentave e materialeve ndihmëse, ashtu edhe në asistencën e vazhduar gjatë proceseve. Kjo, me qëllim rritjen e standardeve të punës së këshillit.

PERFAQESIMI

Roli përfaqësues i këshillit për vitin 2025, është fokusuar në komunikimin e vazhdueshëm me komunitetin dhe tërheqjen e mendimeve on line dhe në formë shkresore. Rritja e sasisë së dokumentacionit të këshillit që publikohen në faqen ëeb dhe në FB, ju ka mundësuar dhe krijuar akses qytetarëve gjatë 2024, për dhënien e mendimit të tyre on line si dhe për të adresuar kërkesë, ankesat apo problematika të tjera me interes për ta.

Këshilltarët kanë përfaqësuar zonat nga vijnë, duke sjellë në Këshill problematika të qytetarëve dhe zërin e tyre, ndërkohë që Këshilli Bashkiak në bashkëpunim me administratën ka zhvilluar Konsultime Publike për akte të cilat janë subjekt i konsultimit publik.

Në zbatim të Ligjit 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit 146/2014 “Për konsultimin publik” dhe duke u bazuar në Rregulloren e Konsultimeve Publike, janë organizuar gjatë 2025 Konsultime Publike :

Ketu duhet te listohen titujt e Konsultimeve publike te zhvilluara gjate 2025

-Kosultim publik për dhenie pasurie me qera

- PBA 2026-2028

- Paketa Fiskale 2026

Konsultimi publik është dokumentuar në Regjistrin e Konsultimeve publike (on line/hard copy), është shoqëruar me proces verbalet dhe një raport drejtuar Kryetarit të Bashkisë për prezantimin, marrjen parasysh dhe buxhetimin sipas mundësive financiare, të kërkesave të paraqitura nga qytetarët.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI BASHKIAK

Janë dokumentuar në Regjistrin e Kërkesë-Ankesave 12 kërkesa/ankesa për vitin 2025, të cilat janë adresuar dhe kanë gjetur zgjidhje në masën 95% në koordinim dhe bashkëpunim me ekzekutivin.

MBIKEQYRJA:

Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit, përvec ushtrimit të këtij roli nëpërmjet sqarimeve dhe pyetjeve nga ana e këshilltarëve në drejtim të administratës për projekt - vendimet e propozuara nga ekzekutivi, në zbatim të planit të aktiviteteve të vitit 2024, u realizuan dhe u paraqitën në këshill informacionet dhe raportet nga administrata sipas kërkesave detyruese ligjore, si dhe atyre të bëra nga vetë këshilli.

Mund të listoni disa raportime të bëra nga ana e administratës në Këshill të parashikuara në planin e aktiviteteve të këshillit, ose të tjera.

-Raportim mbi PBA 2026-2028

-Raportim I monitorimit të Buxhetit për periudhën Janar –Gusht 2025

TRAJNIMET E KESHILLIT

Gjatë 2025, në bashkëpunim me projektin “Bashki të Forta”, u zhvilluan trajnime për lidërshtipin, sekretarët/sekretariatet dhe komisionet e përhershme të Këshillit Bashkiak në periudhën maj-qershor 2025.

Punë të mbarë dhe faleminderit!